



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 10 dhjetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Haki Demolli, Ardian Gjini, Mufera Şinik, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Enver Peci – KGJK, Visar Smajlaj – ekspert, Lejla Selimi – OSBE, Petrit Hysaj – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Lumniye Murati – ZPRK, Shkëlzen Gërxhaliu dhe Fahrije Bajrami – praktikantë.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.11.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat;
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011;
6. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë, nr. 04-P-121/k;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Behar Selimi – Propozoi që si pikë e rendit të ditës të futet edhe raporti me amendamente për Projektligjin nr. 04/L-165, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Komisioni votoi lidhur me propozimin e deputetit Behar Selimi dhe me 5 vota “për”, 4 “kundër” dhe 1 “abstenim”, u fut në rend të ditës.

Kryetari – Propozoi që të fillohet me pikën e pestë të rendit të ditës, pasi është ftuar kryesuesi i Këshillit Gjyqësor për ta prezantuar raportin.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.11.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.11.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011;

Kryetari – Dha një kronologji rreth procedimit të raportit. Ai tha se më 30 maj 2012, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e ka proceduar në Kuvend kërkesën lidhur me prezantimin e aktiviteteve të Këshillit lidhur me performancën, veprimet, shpenzimet dhe nevojat e gjyqësorit. Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e 11 qershorit 2012, e ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vlerësuar se kërkesa e Këshillit ka bazë juridike dhe kishte kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të veprojë në pajtim me ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Kryesia e Kuvendit, më datë 15 qershor 2012, kishe nxjerrë përfundim, me të cilin ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që para se të ftohet kryesuesi i Këshillit që të paraqitet në kuvend, ta parashtrojë raportin për punën e Këshillit. Raporti vjetor i KGJK-së për vitin 2012, i është proceduar Kuvendit, më 12.11.2012. Pra, është proceduar krejt në fund të vitit dhe nuk e di sa do të kemi mundësi që ta shqyrtojmë dhe ta procedojmë në seancë plenare gjatë këtij viti. Raporti përmban informata lidhur me funksionimin e Këshillit, komisionet e Këshillit, strukturën organizative, si dhe çështjet lidhur me procesin e emërimit të gjyqtarëve. Në këtë raport, përveç të dhënave statistikore, në fund kemi edhe një pjesë siç quhet “ Strategjia Shtetërore për reduktimin e lëndëve të vjetra”. Kjo pjesë e raportit është shumë e zbehtë dhe nuk pasqyron në mënyrë të plotë se cila është ajo strategji për reduktimin e lëndëve të vjetra. Në këtë pjesë të raportit thuhet se gjykatat më të ngecura janë gjykata e Mitrovicës që thuhet “fizikisht vepron në Vushtrri”. Unë do të doja të dija pse? Po ashtu, dua të di pse gjykatat në Zubin Potok dhe Leposaviq, nuk janë përfshirë në këtë Strategji ?

Ky raport sipas mendimit të tij nuk është i plotë, sepse nuk jep shumë detaje për defektet në fushat e caktuara dhe më tepër jepen të dhëna statistikore. Dhe, në fund, para se t’ia japë fjalën kryesuesit të KGJK-së, z. Peci, kryetari pyeti: Cilët janë hapat që ka ndërmarrë KGJK-ja për shkeljet e dispozitave ligjore për emërimin e kryetarëve të gjykatave, konkretisht mbi çfarë baze ligjore bëhet rishikimi i vendimeve për emërim?

Enver Peci – Tha se kjo është hera e parë që ky institucion i raporton në formë të tillë Kuvendit, mirëpo meqë kjo kërkohet edhe me Kushtetutë, atëherë KGJK do të njoftojë Komisionin rreth raportit vjetor të vitit 2011. Një ndër sfidat kryesore të KGJK-së ka qenë strategjia shtetërore për zvogëlimin e lëndëve të vjetra, ndërsa kjo për faktin se ka pasur disproporcion mes numrit të grumbulluar të lëndëve dhe numrit të gjyqtarëve, të cilët i kanë trajtuar ato. Statistikat tregojnë se kemi arritur të ulim numrin e lëndëve të viteve të kaluara diku rreth 62%.

Ne, gjithashtu, kemi arritur ta balancojmë numrin e gjyqtarëve, duke zgjedhur 122 gjyqtarë nëpër Gjykatat e Kosovës, por që edhe më tej këtë balancë e sfidon numri i madh i lëndëve të pazgjidhura të viteve të kaluara.

Strategjinë shtetërore për zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra e kanë përfunduar Gjykata Supreme dhe Gjykata për Kundërvajtje, ndërsa që problemi më i madh mbetet ai i përmbarimeve, ku diku rreth 70 mijë raste të këtyre lëndëve janë nga kompanitë që i kanë paditur qytetarët për borxhet e tyre ndaj KEK-ut dhe PTK-së. Numri i këtyre lëndëve, sidomos tek personat që janë të punësuar, do të zvogëlohet pasi është arritur një marrëveshje me Bankën Qendrore dhe Administratën Tatimore të Kosovës, që të gjithë të punësuarit t’i sigurojnë llogaritë bankare, ndërsa Banka Qendrore do t’i

obligojë bankat komerciale që të sigurojnë informacionet mbi të punësuarit, në mënyrë që ndaj tyre të aplikohen ndalesa në pagë.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, ne tashmë kemi raportuar para Komisionit për Buxhet dhe Financa, të cilët edhe kanë dhënë lëvdata për mënyrën e menaxhimit të parasë nga institucioni i KGJK-së.

Një çështje e rëndësishme e përmendur edhe nga kryetari i Komisionit, është zgjedhja e kryetarëve të gjykatave themelore. Kemi arritur që të gjithë të punësuarit t'i sistemojmë dhe të fillojmë zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave themelore, ku në procedurë të rregullt është emëruar kryetari i Gjykatës së Apelit, kanë kaluar 5 kryetarë të gjykatave themelore dhe 2 të tjerë janë peng. Në ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, është paraparë një dispozitë ku KGJK-ja i emëron kryetarët e gjykatave, pas konsultimit me gjyqtarët e gjykatave përkatëse, metodë e cila është aplikuar në të gjitha qendrat e Kosovës.

Kryetari – Si është e mundur që një gjyqtar të kualifikohet për atë pozitë, përderisa nuk i ka plotësuar kriteret ligjore?

Enver Peci – Çështja e propozimit është kompetencë e gjyqtarëve, prandaj ne nuk mund të ndikojmë në atë proces, mirëpo Këshilli Gjyqësor, megjithatë ka votuar për kandidatët e propozuar, pavarësisht sugjerimit tim se duhet të kenë kujdes nëse kandidatët i plotësojnë kushtet. Pas shpalljes së rezultatit, ne kemi pranuar një ankesë nga një kandidat, i cili ka pretenduar se i plotëson kushtet më mirë sesa kandidati fitues, duke u pasuar edhe me një presion nga institucionet ndërkombëtare, i cili pastaj ka rezultuar me revokim të vendimit dhe duke iu nënshtruar edhe njëherë procesit zgjedhor, sipas rregullave dhe standardeve. Gjithashtu edhe në Mitrovicë do të përsëritet procesi zgjedhor, pasi të tre kandidatët kanë marrë numër të barabartë të votave nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Arsim Bajrami – Përsëritja e gatishmërinë e kryetarit të KGJK-së për të raportuar në Komision dhe e vlerësoi këtë si praktikë të rëndësishme. Sa i përket raportit të KGJK-së, ai tha se përgjithësisht është një raport i mirë, por shtoi se ai duhet parë nga shumë dimensione. Me theks të veçantë u përmenden edhe lëndët e vjetra, si dhe procesi i digjitalizimit në administratë, si mënyra më e mirë e rritjes së efikasitetit të punës së këtij institucioni. Kurse çështja e dytë kishte të bënte me implementimin e skemës së re të gjyqësorit, pra të raportohet se në cilën fazë të implementimit të kësaj skeme gjendemi.

Armend Zemaj – Cili është mekanizmi i KGJK-së për të vlerësuar performancën e gjyqtarëve, pasi ata shpesh janë temë kryesore e mediumeve të ndryshme, duke vënë në pah defektet e sistemit të drejtësisë. Çështje tjetër e përmendur ishte mënyra se si është duke e trajtuar KGJK-ja numrin e lëndëve të grumbulluara. Sa i përket çështjes së përmendur më lart, ku janë shkelur procedurat për përzgjedhjen e kryetarëve të gjykatave, ai tha se do të duhej që çështja të kthehej në piken zero si mënyra më e mirë për KGJK-në, që kjo e fundit të mos dalë e njollosur nga ky proces.

Albulena Haxhiu - Raporti i KGJK-së nuk po e pasqyron realitetin e gjyqësorit, pasi në këtë raport janë të paraqitura çështjet teknike, por jo edhe ato përmbajtjesore. Aty vazhdimisht ceken dy fraza: KGJK angazhohet për një gjyqësor të pavarur, të paanshëm, profesional, mirëpo realiteti qëndron ndryshe pasi ne nuk e kemi parë një gjë të tillë, dhe besueshmëria në këtë institucion nuk është rritur aspak. Më tutje thuhet se KGJK-ja i kushton vëmendje informimit publik dhe transparencës, mirëpo në jemi dëshmitar të asaj se gazetarët, shoqëria civile dhe qytetarët, çdo ditë ballafaqohen me përgjigje negative dhe mostransparencë në kërkesat e tyre që i parashtrajnë KGJK-së. Në raport mund të shihet se janë ndërmarrë edhe masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, mirëpo ato masa të ndërmarra mund të cilësohen si qesharake, duke marrë parasysh numrin e madh të shkeljeve nga ta. Pyetja e saj konkrete ishte se çka mendon z. Enver Peci për dënimin që i është shqiptuar gjyqtarit të rastit, Diana Kastrati, dënim ky qesharak dhe tallje me familjen e saj dhe me qytetarët e këtij vendi. Çështje tjetër është edhe buxheti i ndarë për KGJK-në, buxhet ky i pamjaftueshëm dhe që dëshmon se kjo Qeveri, nuk e ka në

interes fortësimin dhe pavarësimin e gjyqësorit. Ajo vlerësoi se ky raport nuk e pasqyron gjendjen reale, prandaj ajo edhe do të abstenojë.

Haki Demolli – Tha se raporti është tejte i vonshëm, pasi Komisioni po analizon një raport të vitit 2011, ndërsa që tani është fundi i vitit 2012. Deputeti Demolli ngriti 3 çështje sa i përket raportit: çështja e parë është numri i lëndëve të pazgjidhura deri në kohën kur është përpiluar raporti, që ka qenë rreth 100 mijë, ndërsa është paraparë që të zgjidhen ose përmbyllen afërsisht 45 mijë lëndë. A kemi ndonjë lëvizje pozitive në këtë drejtim dhe me çfarë numri të lëndëve do të hyjmë në vitin 2013? Çështja e dytë e ngritur është numri i gjyqtarëve, pasi në raport në vende të caktuara përmendet një numër prej rreth 300 gjyqtarësh, kurse në fund të raportit thuhet se janë të punësuar 250 gjyqtarë. Kurse çështja e tretë është shuma e ndarë prej 17 milionë eurosh, ku janë përfshirë edhe pagat e rritura për gjyqësorin kosovar, paga këto relativisht të mira për standardin tonë, mirëpo megjithatë tek qytetarët edhe me tej ekziston një perceptim negativ për gjyqësorin, për shkak se shpeshherë flitet për raste korruptive. Prandaj, ai shtroi pyetjen nëse janë marrë parasysh dosjet e tyre në procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve, dhe për të gjithë ata të cilët janë përfolur për afëra korruptive, sa është numri i tyre të cilët kanë mbetur pa u përfshirë në listën e gjyqtarëve. Gjithashtu, u ngrit çështja e gjyqtarëve të punësuar edhe si profesorë në kolegje të ndryshme, gjë që e dëmton cilësinë e punës së tyre, sidomos marrë parasysh numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykata.

Halit Krasniqi – Vlerësoi lart paraqitjen e kryetarit të KGJK-së për të raportuar para Komisionit. Gjithashtu, ngriti çështjen e kuadrove, të cilët janë pjesë e gjyqësorit tani, për të cilët ishte i interesuar të dijë nëse ka gjyqtarë që i kanë takuar edhe sistemit të padrejtësisë dhe që në dosjet e tyre figurojnë aktgjykime dhe vendime, të cilat kanë qenë të ndikuar nga politika, si dhe vendimet e tyre kanë qenë të njëanshme.

Jasmina Zhivković – Pyeti lidhur me rezervimin e vendeve të pakicave në sistemin gjyqësor. Ajo theksoi se organizimi i sistemit gjyqësor është shumë i rëndësishëm, por nga ajo që përmban raportin nuk e kupton se sa vende janë të rezervuara për pakicat.

Gëzim Kelmendi – Theksoi se vërejtjet më të mëdha në Raportin e progresit bien pikërisht mbi gjyqësorin dhe interferimet politike, pra mbi këtë degë të pushtetit, duke e radhitur kështu Kosovën në vendet me shkallë të lartë të korrupsionit. Ai shtroi pyetjen se cili ka qenë hapi konkret në luftimin e këtij fenomeni, duke vënë theksin në zinxhirin prokuror-avokat-gjyqtar, pasi në vendin tonë është krijuar përshtypja se një avokat i mirë është ai i cili ka lidhje dhe ndikim tek organet vendimmarrëse. Gjithashtu, çështje e ngritur ishte edhe përzgjedhja e kandidatëve, të cilët nuk kanë një pedigree të pastër familjare, e që pikërisht ky fakt po krijon bazën për një sistem gjyqësor të korruptuar.

Behar Selimi – Përgëzoi KGJK-në për transparencën e treguar ndaj qytetarëve të Kosovës dhe për vullnetin e tyre për të raportuar para Komisionit.

Kryetari – Si shpjegohet fakti që raporti mes femrave dhe meshkujve në gjyqësor është në disfavor të gjinisë femërore, sidomos në komuna më të vogla.

Enver Peci – KGJK-ja dhe Komisioni i Pavarur Prokurorial u instalua në vitin 2008, përmes një urdhërese administrative. Pjesë e procesit kanë qenë 5 gjyqtarë ndërkombëtarë, me një përvojë të madhe, dhe ata kanë pasur për obligim të bëjnë vlerësimin dhe verifikimin e të gjithë kandidatëve, të cilët kanë konkurruar në ato pozita, përfshirë këtu Gjykatën Supreme, Prokurorinë e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale. Nga ai proces kanë mbetur pa u përfshirë shumë kolegë, pasi ashtu ka vlerësuar komisioni.

Nga viti 2000 – 2008, paga e gjyqtarit ka qenë 400 euro, gjë që ka ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të tyre në mënyrë drastike, duke bërë kështu që numri i lëndëve të grumbullohet.

Sa i përket çështjes së ngritur nga deputeti Zemaj, ne e kemi rregulloren e vlerësimit të punës së gjyqtarëve, edhe për nga kualiteti, integriteti dhe sjellja, ndërsa përmes kësaj rregulloreje besojmë se vitin e ardhshëm do ta bëjmë vlerësimin. Nëse vërehet se një gjyqtari i anulohen në shkallën e dytë më shumë se 70% të rasteve, atëherë mund të merren masa, pasi vërehet se diçka nuk është në rregull me atë gjyqtar. Sa i përket transparencës, ka probleme sikurse edhe në çdo institucion tjetër, mirëpo tek gjyqësori rastet janë më specifike pasi disa çështje janë të vlerësuara si konfidenciale.

Sa i përket besueshmërisë dhe perceptimit të qytetarëve për punën e gjyqtarëve, mund të thuhet se një rol negativ në këtë aspekt luan edhe pakënaqësia e individëve me vendimet e gjyqësorit, e cila pastaj pasohet me ankesa edhe nëpër medime, duke pohuar se u është bërë padrejtësi, dhe kështu duke ushtruar presion dhe duke shantazhuar punën tonë. Sa i përket përfshirjes së komuniteteve në institucionet e gjyqësorit, fillimisht ka pasur vështirësi, mirëpo me ndihmën edhe të ICO-së kemi arritur ta përmbushim kuotën e përcaktuar nga plani gjithëpërfshirës i Ahtisaarit, me përjashtim të komunave në veri, ku në fakt gjykatat atje nuk funksionojnë fare, madje si rezultat i kësaj, gjykata e Mitrovicës funksionon në Vushtrri, në kushte mizërie dhe me kapacitet 10-15%. Në lidhje me shqetësimin e ngritur nga deputeti Krasniqi, u tha se kriteret për emërimin e një gjyqtari p.sh. të Gjykatës Supreme, kërkohen 12 vite përvojë pune, por gjithsesi është bërë paraprakisht një evoluim i integritetit dhe sjelljeve të gjyqtarëve.

Sa i përket stafit mbështetës, ka nevojë për përmirësime, pasi ne kemi trashëguar një administratë që ishte instaluar në vitin 2000, si nevojë emergjente, por besoj që në vitet e ardhshme edhe Qeveria mund të ndihmojë në këtë proces, përmes vendosjes së kriterëve akademike. Sa i përket numrit të gjyqtarëve në të gjitha nivelet, numri i tyre është 351. Me buxhet, të lejuara janë 390 pozita të gjyqtarëve, mirëpo nuk mund të plotësohet numri i plotë, për shkak të numrit të caktuar për komunitete. Sikur të mos ishin lëndët e trashëguara, atëherë mbase do të arrihej efikasitet i plotë për zgjidhjen e lëndëve, por në sekretariatit e Këshillit Gjyqësor, është duke u bërë një analizë dhe ne si Këshill Gjyqësor mund të transferojmë gjyqtarë në vende ku është më e ngarkuar situata. Shkaktar i ngarkesave të lëndëve janë edhe çështjet përmbartimore, por edhe çështjet penale të regjistruara në shkallë të parë marrin edhe 2-3 numra, pasi në shkallë të dytë merr edhe një numër, kurse në shkallën e tretë merr një numër tjetër, duke ndikuar kështu në trefishimin e numrit të lëndës.

Kryetari – Pyeti kryesuesin e KGJK-së, nëse shpreh interesim për të raportuar para seancës, pasi ne ta dërgojmë rekomandimin.

Enver Peci – Tha se ai tashmë ka raportuar në Komisionin për Buxhet dhe Komisionin për Legjislacion, prandaj do të ishte më e rrugës që në vitin tjetër të raportojë para seancës edhe për raportin e vitit 2011, por edhe atë të vitit 2012, në një raport i cili do ishte më gjithëpërfshirës dhe më me relevancë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, me 10 vota për dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës

Albulena Haxhiu – Tha se për një shtet sovran, si ligji ashtu edhe agjencia që ky ligj e themelon, mendoj se janë të panevojshme, pasi ai e formalizon faktin që librat kadastralë t'i mbajë Serbia. Pas tërë pompozitetit për përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur, ne po themelojmë një agjenci, e cila do të jetë totalisht në kontroll të përfaqësuesit special të BE-së. Shumica e anëtarëve të bordit të sekretarisë, do të emërohen nga PSBE-ja, prandaj ajo shtroi pyetjen se prej nga PSBE merr mandat për emërimin e përfaqësuesve ekzekutivë në Kosovë, mandat të cilin në fakt nuk ia jep, madje as pakoja e Ahtisaarit, pasi pushteti mbi administrimin e pronës është thelbësor për sovranitetin. Pastaj, ku e merr bazën juridike ky ligj. Me këtë ligj ne ndërtojmë një regjistër kadastral, ku të dhënat janë pjesërisht nga regjistri i vjetër, ndërsa pjesërisht nga i ri. Në rast mospërputhje të dhënash, a do t'u besohet regjistrave kadastralë vendorë, apo atyre kopjeve të siguruara nga Serbia dhe të verifikuara nga EULEX-i? Gjithashtu, ky është një rast i paprecedent që një shtet, të mos ketë regjistrin historik të evoluimit të transaksioneve pronësore, pra a nuk do duhej që fillimisht ne të kemi ligj për verifikimin e kopjeve të ardhura nga Serbia. Për këto dhe arsye të tjera të shumta, Lëvizja Vetëvendosje do të votojë kundër këtij Projektligji.

Arsim Bajrami – Tha se administrata do të duhej t'i marrë dhe t'i shqyrtojë amendamentet kushtetuese, që kanë të bëjnë me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, ku ne në mënyrë taksative kemi treguar se në cilat institucione ka prani ndërkombëtare për 3 vitet e ardhshme, dhe nëse në këtë institucion nuk është paraparë prani ndërkombëtare, atëherë këtij ligji i mungon baza kushtetuese. Ekziston një amendament, i cili përcakton se në cilat borde dhe agjenci parashihet prania ndërkombëtare dhe nëse në atë amendament nuk përmendet edhe kjo agjenci, atëherë ky ligj nuk ka bazë kushtetuese.

Kjo pikë u hoq nga rendi i ditës, që të shikohet baza juridike.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat dhe vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim, prandaj vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat.

6. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë, nr. 04-P-121/k

Komisioni shqyrtoi amendamentet kushtetuese, që kanë të bëjnë me futjen e amnistisë, si kategori kushtetuese dhe ndryshimin e nenit 108, të Kushtetutës, të propozuara nga Qeveria.

Komisioni përkrahu amendamentin 2, po ashtu, ka vlerësuar të pranueshëm edhe vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (KO-61/12), e cila për amendamentin 1, paragrafi 1, ka konstatuar se ky amendament i pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në kapitullin II të Kushtetutës.

Lidhur me këtë, Komisioni rekomandoi që amendamentit 1, t'i kthehet propozuesit për riformulim, në pajtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

7. Të ndryshme

Shqyrtimi i Projektligjit për buxhet

Behar Selimi – Tha se e ka analizuar projektligjin dhe amendamentet dhe se nuk ka diçka që është në kundërshtim me ligjet tjera, sa i përket kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Raporti është i përgatitur nga Komisioni Funkcional kompetent dhe kjo është edhe arsyeja se pse ai ka marrë përsipër ta përshpejtojë procedurën. Në bazë edhe të debateve në Kuvend, shihet se ka ndryshime në shifra dhe në investime, por jo edhe në norma, të cilat do të ishin përgjegjësi e jona si Komision, prandaj ai i ftoi anëtarët që ta votojnë këtë projektligj.

Në momentin e votimit të kësaj pike, prezentë ishin 9 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, me 6 vota për dhe 3 kundër, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi